



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Thirrja Publike për mbështetje financiare publike për financimin e
Projekteve / Programeve të OJQ-ve: që kontribuojnë në zhvillimin dhe
avancimin e Kulturës në Komunën e Gjakovës**

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së Thirrjes: 26.03.2026
Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 20.04.2026

P Ë R M B A J T J A:

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-ve NË ZHVILLIMIN DHE AVANCIMIN E KULTURËS NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj Thirrje Publike

1.2 Objektivat e Thirrjes dhe Prioritetet për ndarjen e fondeve

1.3 Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e Projektit / Programit

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

3. SI TË APLIKONI ?

3.1 Forma e përshkruese e projekt propozimit

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Aplikacionet e pranura do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e
Projekteve / Programeve të OJQ-ve:
që kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin e Kulturës në Komunën e Gjakovës.**

**1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE
PUBLIKE**

1.1.1. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.

1.1.1 Ekzistojnë një numër i madh i Organizatave Jo Qeveritare të cilat merren me promovimin e vetëdijesimit të qytetarëve në bashkëpunimin e sektorit privat me Komunën e Gjakovës. Prandaj, edhe kjo thirrje publike për përkrahje të projekteve të Organizatave Joqeveritare të cilat në programin e tyre janë të fokusuar në promovimin e Kulturës, e ideve kreative për të promovuar rritjen e bashkëpunimit të Komunës me OJQ-të.

1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje janë:

- a) Përmbushja e objektivave të DKRS-së të bazuara në planin e punës 2026 që ndërlidhen me Kulturën;
- b) Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve në fushën e Kulturës;
- c) Organizimi i aktiviteteve për shënimin e ngjarjeve të ndryshme me rëndësi në fushën e kulturës;
- d) Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme Kulturore;
- e) Avancimi dhe promovimi i vlerave të mirëfillta në fushën e Kulturës.

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

1. Objektivi specifik i kësaj Thirrje për Propozime është: Përmirësimi i aftësisë së OJQ-ve për të promovuar partneritetin dhe bashkëpunimin e Organizatave Jo-Qeveritare me institucionet lokale, institucionet që veprojnë në fushën e promovimit të bashkëpunimit të Komunës së Gjakovës me OJQ-të.

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile me qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës së Kulturës tek shoqëria civile e më gjerë;
- ✓ Bashkëpunimi i institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe nxitjen e aktiviteteve të Kulturës;
- ✓ Aktiviteti i organizimit të Manifestimeve të ndryshme Kulturore;
- ✓ Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshëm Kulturore;
- ✓ Avancimi dhe promovimi i vlerave të mirëfillta në fushën e Kulturës.

1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTALI I THIRRJES

1. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 500 euro.
2. Shuma maksimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është 8,000 euro
3. Totali i Thirrjes për Kulturë është: 60,000 euro.

Aplikantët dhe partnerët potencialë është nevojshme të sigurojnë bashkëfinancim nga burimet tjera (publike ose private) të financimit.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: Kush Mund të Aplikojë?

OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë,

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se: janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike. Aplikuesit duhet të prezantojnë: certifikatën e numrit fiskal, certifikatën e regjistrimit, letër konfirmimin e personit të autorizuar të OJQ-së, kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar dhe vërtetimin nga Komuna e Gjakovës-DKRS, me të cilin vërtetohet që OJQ-ja nuk ka obligime financiare ndaj Komunës së Gjakovës

OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikoj në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme. OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmanjë financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta.

Të kenë dorëzuar një projek-propozim sipas formularit të aplikacionit të projektit/programit Formulari F9 së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10.

Komisioni Vlerësues i Ofruesit të mbështetjes financiare varësisht nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes publike për përmbushjen e kriterëve formale do të bëjë një vlerësim formal të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit. Përmbushja e kriterëve formale nënkupton dorëzimin brenda afatit të thirrjes të një aplikimi me projekt propozim, së bashku me dokumentet e kërkuara përmes thirrjes.

Disa nga dokumentet kryesore të cilat Ofruesi i mbështetjes financiare varësisht nga thirrja publike do të kërkojë të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
2. Certifikatën e numrit fiskal;
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;
4. Letër konfirmimin ku vërtetohet që OJQ-ja është e regjistruar në Departamentit për OJQ-Ministria e Punëve të Brendshme dhe Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike;
5. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike;

6. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi;
7. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera;
8. Deklaratë se OJQ ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore;
9. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme;
10. Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
11. Të dorëzoj CV të menaxherit të projektit;
12. Të dërgojë dëshmi të implementimit të projekteve/ programeve të ngjashme.

2.2 Partnerët e pranueshëm në zbatimin e Projektit / Programit:

Organizatat Jo Qeveritare në Komunën e Gjakovës të cilat plotësojnë dokumentacionin e kërkuar sikurse të aplikantit kryesor.

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

1. Periudha kohore e zbatimit të projektit: Brenda Vitit;
2. Lokacioni i zbatimit të aktivitetit është në Komunën e Gjakovës;
3. Lista e aktiviteteve që do të përfshihen:

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile me qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës së Kulturës tek shoqëria civile e më gjerë;
- ✓ Bashkëpunimi i institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe nxitjen e aktiviteteve në kuadër të Kulturës;
- ✓ Aktiviteti i organizimit të Manifestimeve të ndryshme Kulturore;
- ✓ Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme Kulturore;
- ✓ Avancimin dhe promovimin e vlerave të mirëfillta në fushën e Kulturës.

Lista e aktiviteteve të projektit nuk është e mbyllur, por vetëm e ilustruar dhe do të merren parasysh për financim edhe aktivitete tjera të përshtatshme që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe specifike të thirrjes, të cilat nuk janë të përmendura në listën më lartë.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikanti duhet të sigurojë që të bazohet në parimin e ofrimit të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit, si dhe të zhvillojë veprimtari në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

2.4.1 Shpenzimet e tërthorta të Pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit). Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

3. SI TË APLIKONI ?

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

3.1 Aplikacioni i projekt propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikusin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike. Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë. Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë. Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin ?

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës.

Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose fizikisht dhe të dorëzohet në Zyrën e DKRS-së. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin:

"Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues".

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve:

Afati i fundi për dorëzimin e aplikacioneve është data 17.04.2026 dhe është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes. Nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet dhe sqarimet në lidhje me thirrjen mund të bëhen në adresën: Rr. "UÇK" p.n. / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi" dhe në email adresën: drenusha.nixha.hoxha@rks-gov.net deri më datën: 07.04.2026.

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themelojë një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësojë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit. Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit.

4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, një ofrues i burimeve financiare do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, ofruesi mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar (jo më pak se 10 ditë), aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të thirrjes

5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes:

1. Afati i fundit për aplikimet : 20.04.2026/16:00h

Financuesi ka të drejtë të përditësojë kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: **kk.rks-gov.net/gjakove/**

6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Formulari i Udhëzimit për Aplikantë

Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (word)

Formulari i Propozim buxhetit (format excel)

Formulari i deklaratës për financim të dyfishtë (format Word)

Formulari i deklaratës e partneritetit (format Word)

Formulari i deklaratës së projekteve të financuara (format Word)

Formulari i deklaratës mbi aktivitetet e përshkruara për kontraktoret (format Word)

Formulari i raportit të përshkruar të projektit (format Word)

Formulari i Raportit Financiar (formatin word/excel)

Formulari i raportit narrativ – përshkrues (format word)